



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 424/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Synavere Rysha kandidatë për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Shtime, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) më dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Synavere Rysha kandidatë për deputete për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, dega në Shtime.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 27.06.2014, në ora 13.18 ka pranuar një ankesë nga Synavere Rysha kandidatë për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, në të cilën ankesë pretendohet se në komunën e Shtimes në tri vendvotime në fshatin Muze qin nga 320 vota të saja janë paraqitur vetëm 131 vota ku pretendon se i mungojnë 189 vota. Ajo pohoi se për shkak të kohës së shkurt nuk ka arritur të sigurojë asnjë provë. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, sepse nuk e posedon asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore dhe nuk ka dhënë asnjë udhëzim dhe hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk kanë qene në posedim të saj lidhur me atë çka pretendon në ankesë, prandaj ankesa vlerësohet si e pabazuar duke u bazuar në Nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet”, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 424/2014 më datën 30.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*